



---

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E MJEDISIT DHE  
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

**MINISTRY OF ENVIRONMENT  
AND SPATIAL PLANNING**

**MINISTARSTVO SREDINE I  
PROSTORNOG PLANIRANJA**

---

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVA  
VLADA KOSOVA

Qeveria e Kosoves,

në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas nenit 30 të Ligjit për planifikim hapësinor nr.2003/14 dhe nenit 1 të Rregullores mbi Degën Ekzekutive nr.19/2001 të dt. 13 shtator 2001 , me propozimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerr këtë

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.5**

**MBI ZBATIMIN E LIGJIT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR MBI  
RREGULLIMIN E MBIKQYRJES, TË NDËSHKIMEVE DHE  
MARRJEN E MASAVE**

**Neni 1**

Mbikqyrja administrative

Mbikqyrjen administrative të zbatimit të dispozitave të këtij Ligji dhe të dispozitave tjera të nxjerra në bazë të këtij Ligji e bën Ministria.

## **Neni 2**

### **Mbikqyrja inspektuese**

2.1. Mbikqyrjen inspektuese të akteve të përgjithshme dhe veç e veç, të kushteve dhe të mënyrës së punës së personave të mbikqyrur juridik dhe fizik dhe të masave të marra të përcaktuara me këtë Ligj e bën Ministria nëpërmes inspektorëve urbanistik (në tekstin e mëtejshëm: Inspektori). Përgjithësisht mbikqyrjen inspektuese mund t'a bëjnë edhe nëpunësit tjerë të Ministrisë në bazë të autorizimeve të veçanta të Ministrit.

2.2. Inspektor mund të emërohet inxhinieri i diplomuar i arkitekturës ose i ndërtimtarisë me më së paku pesë vite përvojë pune dhe provimin e dhënë profesional nga neni 8 i Ligjit për planifikim hapësinor.

2.3. Cilësia zyrtare e inspektorit përcaktohet me legjitimacion. Formulari i legjitimacionit dhe mënyra e lëshimit të tij caktohet me vendim administrativ të Ministrisë.

## **Neni 3**

### **Të drejtat dhe detyrat e inspektorit**

3.1. Në ushtrimin e mbikqyrjes inspektuese, inspektori kontrollon posaçërisht:

- Nëse personi juridik është regjistruar për kryerjen e punëve profesionale të planifikimit hapësinor ose nëse arkitekti i autorizuar i plotëson kushtet e përcaktuara i cili në mënyrë të pavarur i kryen punët profesionale të planifikimit hapësinor;
- Nëse dokumenti i planifikimit hapësinor ose projekti i lokacionit është hartuar dhe nxjerrë në pajtim me Ligjin dhe dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji;
- Nëse ndryshimet e gjendjes në hapësirë bëhen në pajtim me këtë Ligj dhe dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji.

3.2. Personi juridik i regjistruar për kryerjen e punëve profesionale të planifikimit hapësinor ose arkitekti i autorizuar i cili në mënyrë të pavarur i kryen punët profesionale të planifikimit hapësinor, kanë për detyrë që inspektorit t'i mundësojnë inspektimin e plotë dhe pa pengesë të dokumentacionit me të cilin disponohet.

## **Neni 4**

### Autorizimet e inspektorit

#### 4.1. Në kryerjen e mbikqyrjes inspektuese, inspektori:

- Me vendim do të urdhërojë harmonizimin e punës, përkatësisht të dokumentacionit të personit juridik të regjistruar për kryerjen e punëve profesionale të planifikimit hapësinor ose arkitektit të autorizuar i cili në mënyrë të pavarur kryen punët profesionale, nëse vërtetohet se dokumenti i planifikimit hapësinor ose projekti i lokacionit hartohet në kundërshtim me këtë Ligj, dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji, me ligje të veçanta ose me dispozitat e nxjerra në bazë të këtyre ligjeve;
- Me vendim do të ndalojë ushtrimin e veprimtarisë nëse personat juridik për kryerjen e punëve profesionale të planifikimit hapësinor ose arkitekti i autorizuar i cili në mënyrë të pavarur kryen punët profesionale të planifikimit hapësinor, nuk i plotësojnë kushtet e pëcaktuara;
- Me shkrim do t'ua tërheq vërejtjen përgjegjësve në komunë nëse konstaton se dokumenti i planifikimit hapësinor, nxirret ose është nxjerrë në kundërshtim me këtë Ligj, dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji, me ligjet e veçanta ose dispozitat e nxjerra në bazë të këtyre ligjeve;
- Do t'ia shqiptojë dënimin në vend në shumën më të vogël të përcaktuar për kundërvajtjen e bërë nga neni 5 i këtij udhëzimi administrativ;
- Do t'i propozojë organit kompetent shlyerjen nga regjistri publik veprimtarinë për të cilën konstatohet se personi juridik ose arkitekti i autorizuar nuk i plotëson kushtet e pëcaktuara të parapara me ligj të veçantë.

4.2. Në vendimet administrative (më tej: vendimi) të inspektorit mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa në vendimin e inspektorit nuk e shtyen zbatimin e vendimit.

## **Neni 5**

### Gjobat

5.1. Me gjobë në të holla në shumë prej 20.000 deri 50.000 EU do të dënohet për kundërvajtje personi juridik, përkatësisht fizik nëse:

- Harton ose përgaditë dokumentin e planifikimit hapësinor apo të projektit të lokacionit, ndërsa nuk i plotëson kushtet e parapara;
- Harton projektin e propozimit të dokumentit të planifikimit hapësinor apo të projektit të lokacionit në kundërshtim me këtë Ligj, të dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji apo ligjeve të veçanta;
- Nuk mundëson kryerjen e kontrollit të inspektorit ose nuk dërgon, në afatin e caktuar, në inspektim të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e kontrollit.

5.2. Për kundërvajtje nga pika 5.1. e këtij neni do të dënohet me gjobë në të holla në shumën prej 1000 deri në 10.000 EU edhe personi përgjegjës te personi juridik.

5.3. Për kundërvajtje nga pika 5.1. alinea 2 e këtij neni e kryer për herë të dytë, bashkë me dënimin në të holla do t'i shqiptohet edhe masa e marrjes së lejes për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh, ndërsa për kundërvajtjen e kryer për herë të tretë, bashkë me dënimin në të holla, i shqiptohet edhe masa e marrjes së lejes për kryerjen e veprimtarisë në kohë zgjatje prej gjashtë muajsh deri në një vit.

## **Neni 6**

### Zbatimi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mund të lëshojë udhëzime lidhur me zbatimin e këtij udhëzimi administrativ.

## **Neni 7**

### Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri i Kosovës, Bajram Rexhepi.

Prishtinë, më

27.04.2004

Kryeministri, Bajram Rexhepi

---